REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPREČAVANJE KORUPCIJE
AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION
Dep. DPKI 06-01/5050/22
Nr. Faq. 02 29.12.2022

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, nenit 11 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me nenin 29, paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-017, për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 28.12.2022, nxjerrë këtë:

V E N D I M

Mbyllet rasti AKK-DPKI-06-3722/22, për zyrtarin e lartë z. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës Rinisë dhe Sportit, për shkak se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt interesi, për zyrtarin e lartë z, Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës Rinis dhe Sportit është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin nr. 06/L-011, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (në vijim: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Ky rast ka filluar të trajtohet sipas detyrës zyrtare, përkatësisht pas dyshimeve të ngritura nga jashtë (në vijim: raportuesi i rastit), ku janë ngritur pretendimet për konflikt të mundshëm të interesit lidhur me mbështetjen që Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS), i ka dhënë projektit për OJQ-në "Fondacioni Lumbardhi", (konkursi për mbështetej të projekt-propozimeve të OJQ-ve për art dhe kulturë për vitin 2022) duke konsistuar se ministri aktuali i kësaj ministrie, Hajrulla Çeku ka qenë njëri nga themeluesit e OJQ-së "Fondacioni Lumbardhi".

Pasi është shqyrtuar dhe analizuar informata e pranuar nga jashtë, me qëllim të sqarimit të gjithanshëm të këtij rasti Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, përmes shkresës zyrtare DPKI-06-01/3780/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, është organizuar dhe mbajtur një takim, ku janë ballafaquar të gjitha faktet, provat dhe informatat relevante lidhur me rastin në fjalë. Në takim pala ka deklaruar se: "Subvencionimi i organizatave të shoqërisë civile dhe individëve rregullohet me Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, e cila parasheh kriteret dhe rregullat e mbështetjes financiare përmes subvencioneve. Sipas kësaj Rregulloreje, procesi nga shpallja e thirrjeve publike për subvencionim e deri te vlerësimi i aplikimeve dhe shpallja e rezultateve udhëhiqet nga administrata publike-shërbimi civil i ministrisë, respektivisht komisionet e veçanta që në

www.akk-ks.org | info@akk-ks.org | +383 (0) 38 518-005 +383 (200) 10-745

përbërje kanë zyrtarë të administratës dhe profesionistë të jashtëm e përfaqësues të komunitetit. Në asnjë nga hapat e procesit të subvencionimit të organizatave dhe individëve nuk ka përfshirje të ministrit apo të stafit politik të ministrisë.

Po ashtu ka deklaruar se ka qenë pjesë e shoqërisë civile mbi 15 vjet, deri në tetor të vitit 2017 kur ka pranuar detyrën e zëvendës ministrit të turizmit dhe mjedisit në qeverinë e Republikës së Shqipërisë. Gjatë karrierës në shoqëri civile, ka qenë pjesë e shumë nismave, programeve, projekteve dhe organizatave të shoqërisë civile në fushën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore në kapacitete të ndryshme, qoftë si nismëtar, themelues, anëtar bordi, anëtar Kuvendi, drejtor ekzekutiv, staf profesional, konsulent, bashkëpunëtor i jashtëm apo tjetër.

Ndërsa, sa i përket dyshimeve të ngritura në raport me subvencionimin e OJQ "Fondacioni Lumbardhi" nga Ministria e Kulturës, i njëjti ka deklaruar se dikur ka udhëhequr nismën e shoqërisë civile për mbrojtjen e kinemasë Lumbardhi në Prizren nga viti 2007, e cila ka synuar të shpëtojë këtë kinema nga privatizimi, dhe eventualisht rrënimi apo ndryshimi i destinimit kulturor. Pas suksesit të kësaj nisme të gjatë të shoqërisë civile dhe për të ofruar një model menaxhimi për këtë hapësirë, një nga veprimet e asaj kohe ka qenë themelimi i organizatës "Fondacioni Lumbardhi" në vitin 2015, ku kam qenë njëri nga pesë bashkëthemeluesit. Megjithatë, nga korriku i vitit 2017 nuk është pjesë e Fondacionit Lumbardhi.

Më pas, në drejtim të sqarimit të mëtutjeshëm të këtij rasti, Agjencia ka kërkuar informacion shtesë nga Institucione përkatëse të Republikës së Kosovës, dhe nga përgjigja e këtyre Institucioneve (DEP/OJQ-MPB), rezulton se z. Hajrulla Çeku, nuk është anëtar i organit drejtues të OJQ-së "Fondacioni Lumbardhi".

Andaj, në bazë të vlerësimit të gjendjes faktike si më lartë, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit në rastin konkret sipas pretendimeve të raportuesit të rastit, duke marr parasysh se Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ka përcaktuar rregullën se Organizata joqeveritare nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitojë fonde nga institucioni ku ushtron detyrën zyrtari që është anëtar i organit drejtues në këtë organizatë. Në këtë rast z.Hajrullah Çeku, është vërtetuar se nuk është anëtar i organit drejtues të OJQ-së Fondacioni Lumbardhi.

Nga sa u tha më lartë, Agjencia duke u mbështetur në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme për ekzistimin e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit sipas dyshimeve fillestare me rastin e inicimit të këtij rasti, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

Yll Buleshkaj
Drejtor i Agjencisë
për Parandalimin e Korrupsionit

www.akk-ks.org | info@akk-ks.org | +383 (0) 38 518-005 +383 (200) 10-745